Raport studimor
“Varfëria dhe fëmijët” për vitin 2012, qarku Dibër



Përgatiti:
Eksperte Rajonale, Dibër
Majlinda Hoxha
Prill 2014

Lista e Shkurtimeve

DRSHS	– Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social
IT	- Information Technology (Teknologji informacioni)
DRSKSH	– Drejtoria Rajonale e Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor
DAR	– Drejtoria Arsimore Rajonale
DSHP	– Drejtoria e Shëndetit Publik
NJDF	– Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
NJMF	– Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
VKM	– Vendim i Këshillit te Ministrave
Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
UN	– United Nations (Kombet e Bashkuar)
KDF	– Konventa për te drejtat e fëmijëve
NE	– Ndihme Ekonomike
DPGJC	– Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
AK	– Aftësia e kufizuar

I - Parathënie dhe falënderime

“Observatori për të drejtat e fëmijës” është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse, me aktivitet në nivel kombëtar,duke mbuluar çështjet e të drejtave të fëmijëve në të 12 qarqet e vendit, përfshirë edhe atë të Dibrës. Megjithëse një organizate me zyra qendrore në Tiranë, Observatori për të drejtat e fëmijëve operon me zyra dhe ekspertë rajonalë sipas qarqeve, duke qenë i fokusuar në një sërë drejtimesh që lidhen me njohjen dhe vlerësimin e masës së respektimit të të drejtave të fëmijëve. Si rezultat i punës së bërë deri tani nga ky rrjet ekspertësh, Observatori ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm duke qenë ideatori dhe promotori në ngritjen e mekanizmave të monitorimit të të drejtave të fëmijëve nga niveli lokal në atë kombëtar nëpërmjet mbledhjes, përpunimit, analizimit dhe vlerësimit të të dhënave statistikore. Kjo qasje është efektive jo vetëm në kuadër të analizës fokusuar në një vit të dhënë sipas fushave të të drejtave të fëmijëve, por të dhënat tashmë janë progresive duke na dhënë mundësinë ta shtrijmë analizën që nga viti 2008 e deri tani.
Njëkohësisht informacionet e detajuara të mbledhura për një numër të konsiderueshëm treguesish na japin mundësinë të bëjmë gjithashtu analiza të thelluara që lidhen me respektimin e të drejtave të fëmijëve në fusha të veçanta si dhe në njësi vendore të veçanta sipas interesit.

Si rezultat i aktivitetit konkret, të dukshëm dhe intensiv që nga viti 2009, Observatori Dibër është ndër partneret rajonal që njihet dhe vlerësohet për kontributin e dhënë lidhur me integrimin e çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve në planet e zhvillimit rajonal në Dibër. Qasja e përdorur nga Observatori dhe metodologjia e ndjekur për këtë qëllim, vlerësohen mjaft nga strukturat lokale dhe njësitë vendore në Dibër.
Duke qenë një qasje bashkëkohore e testuar praktikisht dhe e vlerësuar si e suksesshme për çështjen e të drejtave të fëmijëve, ajo është parë me interes nga qarku Dibër duke filluar përdorimin e saj për çështje që lidhen me zhvillimin lokal dhe rajonal në përgjithësi.
Krijimi i bazës së të dhënave dhe monitorimi nëpërmjet treguesve statistikore (ku përfshihen edhe tregues që lidhen me respektimin e të drejtave të fëmijëve) është një aktivitet që ka filluar në qarkun Dibër dhe është bërë pjesë integrale e vlerësimit të ecurisë së zbatimit të Strategjisë së zhvillimit të qarkut Dibër.
Partneriteti i gjerë rajonal ka qenë dhe është një ndër synimet e punës së Observatorit Dibër. Mbështetja e dhënë nga strukturat lokale dhe rajonale padyshim është ndër faktorët e rëndësishëm të arritjes së suksesit ndër vite. Ky partneritet tashmë është i konsoliduar, gjë që reflektohet në operativitetin dhe saktësinë e të dhënave të ofruara nga ana e tyre për observatorin Dibër.
Ekspertja e Observatorit Dibër e ndan suksesin e saj në përmbushje të detyrave me përfaqësuesit/punonjësit e institucioneve lokale/rajonale si vijon:
Z. Shukri Shehu, Drejtor i DRSHS Dibër, Z. Ferdi Fida, menaxher i IT pranë DRSKSH Dibër, Z. Zenulla Mehmeti, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Integrimit dhe Zbatimit Këshilli i Qarkut Dibër, Znj. Nevila Manga eksperte e NJDF qarku Dibër, Znj. Vasfie Seferi Përgjegjëse e zyrës së statistikave DSHP Dibër, Znj. Roza Kurtaga Përgjegjëse e statistikave DAR Dibër, etj.

Një falënderimi i veçantë shkon gjithashtu për stafin e Observatorit kombëtar dhe veçanërisht për znj. Elma Tërshana, Drejtore ekzekutive e Observatorit, znj. Mina Mata, administratore kombëtare e të dhënave për fëmijët.

II - Hyrja

Përgatitja e raporteve periodike (kryesisht vjetore) mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve në Dibër, arritjet, problematikat, sfidat dhe prioritetet e sugjeruara është tashmë një praktike e konsoliduar e punës së Observatorit Dibër.
Observatori synon që të alternojë punën e tij si në analiza në përgjithësi për të drejtat e fëmijëve, ashtu dhe në analiza sektoriale, fokusi i të cilave është analiza e thelluar e fushave të veçanta në të cilat vlerësohet reflektimi i respektimit të të drejtave të fëmijëve në nivel qarku.
Raporti në vazhdim prezanton gjendjen e të drejtave të fëmijëve në Dibër dhe ndikimin varfërisë në këtë çështje.
Zhvillimi ekonomik është një proces dinamik që përfshin të gjitha forcat e afta për punë si dhe burimet lokale dhe rajonale, shoqëruar dhe bashkërenduar me politikat rajonale dhe kombëtare që drejtojnë dhe koordinojnë procesin e zhvillimit. Megjithatë mundësitë, burimet, kapacitetet janë lokale dhe ndikimi i tyre në procesin e zhvillimit është i ndryshëm sipas rajoneve.
Ndikim kanë gjithashtu edhe politikat dhe strategjitë kombëtare. Megjithëse efekti i tyre pritet të jetë i dukshëm në nivel kombëtar, rezultatet faktike vijnë në masë të reduktuar përgjithësisht në zonat rurale, për shkak të vështirësive që paraqet aksesi i këtyre zonave ndaj mundësive të përqendruara në zonat qendrore te vendit.

Raporti synon që të bëjë një analize më ë hollësishme të nivelit ekonomik të rajonit të Dibrës e reflektuar në tregues statistikor pjesë e paketës së monitorimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve, me të cilët operon Observatori në nivel kombëtar prej vitesh.
Përgatitja e këtij raporti synon vlerësimin e zhvillimit lokal jo vetëm si çështje e jetesës së popullsisë së rajonit Dibër (pjesë e të cilës janë dhe fëmijët), por synon të na japë një projeksion të qartë të ndikimit të varfërisë tek fëmijët.
Në fakt ky këndvështrim është mjaft i rëndësishëm pasi ndikimi i varfërisë matet për periudhën në raportim, por ndikimi i saj është afatgjatë dhe mangësitë e sotme në këtë drejtim do reflektohen dukshëm në të ardhmen e shoqërisë/komunitetit të rajonit tonë.
Ky raport nga njëra anë është një bazë e mirë referimi për njësitë vendore në Dibër në drejtim të rishikimit të prioriteteve të zhvillimit sipas njësive vendore dhe në nivel rajoni, nga ana tjetër është një vlerësim analitik i cili do t'ju vijë në ndihmë NJDF në qark, NJMF dhe personave përgjegjës në njësitë vendore që për shkak të detyrimit ligjor janë tashmë të përfshirë direkt në monitorimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve në Dibër.
Në fakt përgatitja e raporteve periodike për qarkun Dibër, është pjesë e një procesi të koordinuar dhe integruar në përpjekjet kombëtare që Observatori bën për vlerësimin statistikor analitik të situatës lidhur me të drejtat e fëmijëve nga niveli i çdo njësie vendore deri në nivel kombëtar. Në fakt vetë krijimi i bazës së të dhënave është një standard përgjithësisht i munguar për Shqipërinë në aspekte të ndryshme të procesit të zhvillimit. Për më tepër bashkëpunimi mes strukturave për ndarjen e informacioneve dhe unifikimin e treguesve ndodh shume pak. Për rrjedhojë analizat objektive janë jo të lehta. Megjithatë edhe në aspektin e treguesve të përdorur dhe mënyrës përftimit të tyre Observatori është një standard më vete për vendin tonë në përgjithësi, dhe sidomos për mundësinë e vlerësimit të situatës edhe në zonat rurale duke identifikuar problematikat specifike.
Është bërë praktikë tashmë përdorimi i DevInfo-s, sistem ky i certifikuar nga UN dhe që përdoret në vende të cilat punojnë dhe monitorojnë bazuar në standarde të Kombeve të Bashkuara procesin e zhvillimit.

Megjithëse Observatori fokusohet tek interesat e fëmijëve, nëpërmjet metodologjisë që ai përdor në përmbushje të qëllimit te tij, prezanton njëkohësisht një model në mundësinë e përafrimit/ përdorimit të integruar të standardeve ndërkombëtare (siç është sistemi i mësipërm i monitorimit) me ato kombëtare (siç janë treguesit e rinj të miratuar me vendimet përkatëse dhe të dhënat statistikore të prodhuara nga strukturat lokale dhe rajonale) që monitorojnë të drejtat e fëmijëve në të gjitha nivelet. Në aspektin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve Observatori është partner dhe ndihmës i përpjekjeve që qeveria po bën në këtë drejtim.

Si pjese e konsoliduar e punës së Observatorit, informacionet e përfshira në këtë raport vijnë nga bashkëpunimi me institucionet lokale dhe rajonale Dibër (të dhënat statistikore), nga takime me grupe interesi në të 3 rrethet e qarkut si dhe nga takime e diskutime me ekspertë rajonalë sipas fushave të vlerësimit të treguesve.

Në këtë raport, në procesin e vlerësimit të ndikimit të varfërisë tek fëmijët, janë integruar të dhëna sasiore të marra në institucionet rajonale Dibër me informacione cilësore nga persona aktive lokal si dhe informacionet e marra direkt nga fëmijët, duke i ballafaquar ato me politikat qeveritare dhe standardet kombëtare e lokale, si një qasje që jep mundësi për të vlerësuar progresin dhe çështjet kritike si në niveli i qarkut ashtu dhe në nivel njësish vendore.

Çështje e të drejtave të fëmijëve ka qenë dhe është pjesë e planeve të veprimit si në nivel lokal ashtu dhe në nivel kombëtar. Gjithashtu fëmijët si një ndër grupet e popullatës, por jo vetë janë përfitues të programeve të ndryshme qeveritare si dhe nga projektet e organizatave të ndryshme joqeveritare. Pavarësisht progresit që bëhet, baza ligjore plotësohet në vazhdimësi duke kërkuar gjithnjë e më shumë vëmendje ndaj të drejtave të fëmijëve nga pjesa dërmuese e strukturave shtetërore në të gjitha nivelet.
Për rrjedhje raporti në tërësinë e tij tenton të masë dhe vlerësojë përpjekjet që janë bërë në Dibër për përmbushjen e detyrimeve ligjore në drejtim të respektimit të të drejtave të fëmijëve në vitin 2012.

Dokumentet referente të përdoruar si drejtime progresi kanë qenë KDF, ligje në vendin tonë, VKM, raportet vjetore të Observatorit, strategji dhe politika rajonale, raporte të organizatave të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, studime të ndryshme në këtë drejtim.
Materialet e përdorura do ti gjeni në pjesën e Bibliografisë, aneks i këtij raporti.

Siç u përmend më sipër, të dhënat për raportin janë sasiore (treguesit që Observatori mbledh prej vitesh), dhe informacione cilësore të marra nga takimet direkt me grupe të ndryshme sociale.
Grupet e përfshira në diskutime janë:

- Grupe nxënësish që njohin të drejtat e tyre dhe që janë në gjendje të vlerësojnë situatën reale lidhur me këtë çështje në rajonin e Dibrës.
- Përfaqësues të strukturave lokale/rajonale që kanë në fokus të punës së tyre mbështetjen e fëmijëve
- Prindër nga komunitetet në Dibër.

Në këto takimet me grupet fokus morën pjese *35 të rritur nga 3 rrethet* , *37 fëmijë nga 10* njësi vendore në Dibër.

Takimet me grupet e mësipërme janë orientuar drejt çështjeve me interes në drejtim të vlerësimit të varfërisë dhe ndikimit të saj në jetën e fëmijëve në Dibër.

Treguesit statistikorë të analizuar ishin si vijon:

- Numri i fëmijëve qe jetojnë në familje me ndihme ekonomike
- Numri i familjeve me fëmijë 0-18 vjeç, të cilat janë në skemën e ndihmës ekonomike
- Fondi që kanë përfituar familjet me ndihme ekonomike dhe fëmijët që jetojnë në këto familje
- Fondi i dhënë për personat me Aftësi të kufizuara
- Fondi i dhënë nga buxheti i shtetit për njësitë vendore
- Buxheti për fëmijët në nivel qarku

Pavarësisht punës së bërë, raporti ka kufizimet e veta.

- Varfëria është një çështje vazhdimisht kritike për vendin tonë, megjithatë studimet për matjen nivelit të saj janë në përgjithësi të vështira. Kjo bëhet më e vështirë sidomos kur bëhet fjalë për vlerësimin në nivel rajonesh duke qenë se treguesit janë të përgjithshëm.
- Të dhënat statistikore të përdorura për vlerësimin e nivelit të varfërisë, në fakt nuk prodhohen për të bërë analiza dhe vlerësime për këtë çështje, por janë pjesë e politikave sociale, për rrjedhoje ato nuk tregojnë nivelin real të varfërisë.
- Treguesit e përdorur nuk janë përllogaritur duke pasur parasysh nevojat reale të familjeve në vështirësi mbijetese, por sipas mundësive të shtetit për të mbështetur këto grupe.
- Raporti nuk na jep situatën reale të varfërisë pasi një pjesë e familjeve që nuk kanë as tokë në përdorim, nuk përfitojnë NE për shkak të mos plotësimit të procedurave ligjore.
- Pavarësisht vlerësimeve nëpërmjet treguesve të mësipërm, nuk ka vlerësime për grupe të veçanta shoqërore apo për hendekun e varfërisë, duke mundësuar vlerësimin e varfërisë nëpërmjet treguesve të mesatarizuar, si e vetmja qasje për përgatitjen e raportimit.

Megjithatë raporti vlerëson dhe analizon tregues të prodhuar në mënyrë zyrtare nga strukturat shtetërore, gjë që e bën analizën dhe vlerësimin real dhe me mundësi përdorimi periodik.
Raporti ka një tjetër aspekt mjaft pozitiv, që lidhet me faktin se përdor tregues që janë të unifikuar si rezultat i të dhënave statistikore të unifikuara mbi të cilat ai mbështetet. Këto të dhëna gjenden përgjithësisht në nivel lokal rajonal duke na dhënë mundësi të bëjmë jo vetëm vlerësime vertikale (për vite të ndryshme), por dhe krahasime e vlerësime horizontale (për njësitë vendore në një vit të dhënë)

III - Analiza e varfërisë në Dibër dhe ndikimi i saj në të drejtat e fëmijëve

1. Përshkrim i përgjithshëm i situatës së të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku

Dibra si rajon ka qenë pjesë e rajoneve në të cilët observatori ka fillimet e punës së tij që nga viti 2009. Për rrjedhojë monitorimi i të drejtave të fëmijëve nëpërmjet treguesve statistikore (por jo vetëm) është një proces që fillon që nga viti 2008. Të dhënat dhe informacionet e grumbulluara për monitorimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve jo vetëm janë shtuar, por dhe përmirësuar në vite duke bërë të mundur jo vetëm vlerësime periodike vjetore për këtë çështje, por duke na dhënë mundësinë të masim progresin, tendencat apo nevojën për më shumë vëmendje.
Sipas të dhënave të marra nga DPGJC Tiranë, për vitin 2012 qarku Dibër ka pasur një popullsi të regjistruar prej *179,039 banorësh* me *47,047 familje* gjithsej në 3 rrethet e tij, Bulqizë, Dibër dhe Mat, me mesatarisht *3,8 banore/familje*.

Nga të dhënat demografike të grumbulluara periodikisht nga ana e Observatori, qarku Dibër ka një popullsi me dinamike rritje te ngadalta, të qëndrueshme sidomos në vitet e fundit.
Popullsia është në moshe mesatare të re. Fëmijët janë një grupmoshe e konsiderueshme brenda popullsisë së rajonit/qarkut. Për vitin 2012 qarku Dibër ka pasur një numër prej *55,293 fëmijësh te grupmoshës 0-18 vjeç*. Krahasuar me këtë grupmoshe e vlerësuar për vitin 2011 (*53,809 fëmijë 0-18 vjeç*), në vitin në raportim kemi një rritje të numrit të fëmijëve me *1484 fëmijë*. E përllogaritur në përqindje, rritja e grupmoshës fëmijë në vitit 2012 krahasuar me vitin 2011 është *2,76 %* .
Ndaj numrit total të banorëve, fëmijët, për vitin 2012 zënë *30,9 %* të popullsisë në nivel qarku, krahasuar me nivelin *30 %* [1]që ishte në vitin 2011.

Mirëqenia dhe interesi më i lartë i fëmijëve, është boshti i analizës së mëposhtme në këtë raport. Nga pikëpamja sociologjike dhe psikologjike mirëqenia përshkruhet me termin e "kënaqësi ndaj jetës" dhe të "lumturisë" që çdo individ ka arritur, krahasuar me aspiratat dhe synimet e projektuara[2].
Në fakt "interesi më i lartë i fëmijës" është qëllimi i të gjitha përpjekjeve që bëhen në të gjitha nivelet në Dibër. Pavarësisht vështirësive ekonomike, prindërit mundohen të gjejnë mundësi jo vetëm për rritjen e fëmijëve me sa më shumë mundësi, por edhe duke synuar një të ardhme sa më të mirë për ta.
Megjithatë fëmijët vazhdojnë të jenë një grup *pak i vlerësuar* dhe *përfaqësuar* kur vjen puna për respektimin e të drejtave të tyre në përputhje me KDF apo dokumente të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
Niveli ekonomik është një faktor mjaft i rëndësishëm që ndikon në fokusimin e pakët tek njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve në familje. Dibra si rajon është klasifikuar si një ndër qarqet më të varfra të vendit. Burimet financiare dhe të ushqimit për familjet janë të pakëta. Problemet e jetesës nga njëra anë e bëjnë të vështirë vendosjen e një komunikimi të vazhdueshëm dhe funksional mes prindërve dhe fëmijëve, nga ana tjetër mundësitë e familjeve për të marrë në konsideratë nevojave e fëmijëve në vazhdimësi, por që këto burime financiare janë të kufizuara.

[1] Raporti I Observatorit Dibër për vitin 2011
[2] Matja e mirëqenies së fëmijëve në Shqipëri duke përdoruar vrojtimet MICS dhe ADHS, V Kolpeja,

Mentaliteti mbetet një problem, që ndikon negativisht në konsiderimin e fëmijëve si partnerë brenda familjes dhe në komunitet. Mendohet që të rriturit mund të japin mendimet më të vlefshme edhe kur bëhet fjalë për çështje që lidhen me rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

2. Varfëria si koncept, perceptimi, matja e saj

Varfëria është një koncept mjaft i gjerë në tërësinë e elementeve që mundësojnë jetesën normale për një njeri. Për shkak të kompleksitetit të saj si çështje, specifikat në perceptim dhe gamës së gjerë të treguesve që e ndikojnë atë, nuk ka një përkufizim të vetëm, i cili të përmbledhë të gjithë faktorët që e prodhojnë dhe pasojat që shkakton. Megjithatë ajo gjendet si përcaktim në mjaft studime të bëra me synim fokusimin e analizës mbi varfërinë dhe ndërtimin mbi të të politikave të pjesshme sektoriale, si pjesë e procesit të zhvillimit.

Varfëria është uri. Të jesh i varfër do të thotë të mos kesh strehë, të jesh i sëmurë dhe të mos kesh mundësi të vizitohesh te mjeku; do të thotë të jesh i papunë dhe të mos kesh një të ardhme të sigurt; varfëri do të thotë të jesh analfabet, të mos kesh mundësi për kushte shëndetësore dhe të të mungojnë shumë shërbime e mjete për jetën e përditshme [3].
Varfëria është një nder aspektet në të cilat e rëndësishme për tu marrë në konsideratë edhe në planet e qeverisë në termat afatshkurtër dhe afatmesëm.[4]
Treguesit e monitoruar nga Observatori janë në një numër të konsiderueshëm dhe në vazhdimësi gjatë viteve të fundit[5], megjithatë është hera e parë që vlerësohet në mënyrë më të thelluar varfëria në Dibër si dhe ndikimi i saj në jetën e fëmijëve në këtë rajon.
Qasja e përdorur për përgatitjen e këtij raporti është vlerësimi analitik statistikor, bazuar në politikat në vend lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Bazë në këtë analizë është ligji 10 347, datë 4.11.2011.
Megjithëse monitorimi i të drejtave të fëmijëve është parashikuar në ligj, duke ngritur kështu edhe strukturat institucionale dhe mekanizmat për këtë qëllim [6], ky proces është akoma larg të qenit i mirëorganizuar dhe prioritet real në të gjitha nivelet e qeverisjes, aq më tepër në zonat rurale.
Megjithëse është e vështirë (siç u tha dhe e sipër), vlerësimi i varfërisë në Dibër do bëhet për vitin 2012, ne vazhdim te raportit. Synimi nga njëra anë do jetë matja e varfërisë nëpërmjet treguesve që lidhen me jetesën në terma ekonomike, nga ana tjetër do synohet vlerësimi i ndikimit të varfërisë në jetesën e fëmijëve ne aspektin e shëndetit, arsimit, mbrojtjes sociale dhe sigurisë së fëmijëve.
Njëfarë reference për këtë raport do jetë Karta raportuese Nr 1, e përgatitur nga Observatori Tiranë për vitin 2012.[7]
Siç u tha më sipër, duke qenë se nuk ka tregues specifik shumë të drejtpërdrejtë që masin varfërinë në dimensionet e saj, për analizën e saj është vlerësuar projeksioni i varfërisë në nevojën për mbështetje me NE si dhe buxheti i qarkut dhe ai i akorduar nga qeveria për njësitë vendore në qark.
Analiza e treguesve të mësipërm jepet në vazhdim të raportit.

---

[3] Kushtet e jetesës dhe pabarazia në Shqipëri, INSTAT 2002
[4] Vendimi Nr 182, datë 13.3.2012, Për miratimin e planit të veprimit për fëmijë, 2012-2015
[5] Raportet vjetore, Observatori Tiranë, 2008, 2009 ,2010 dhe 2011
[6] VKM 266, datë 12.4.2012 "Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës";
[7] Varfëria e fëmijëve në Shqipëri për vitin 2012, Observatori 2013.

3. Varfëria nëpërmjet treguesve të ndihmës ekonomike

Në fakt NE është një tregues direkt që mat nevojat për burime financiare. Pavarësisht procedurave ndonjëherë dhe jo shumë korrekte, ajo tregon përgjithësisht familjet në nevojë.
Për vitin 2012 ***numri i fëmijëve 0-18 vjeç që jetojnë në familjet pjesë e skemës së NE*** është si më poshtë:

Burimi. DRSHS Dibër

Njësia vendore	Numri I fëmijëve
Bulqizë	11246
Dibër	19394
Mat	12748
Dibër (qark)	**43388**

Tabele 1. *Numri i fëmijëve që kanë jetuar në familje në NE, Dibër 2012*

Nga tabela 1 shihet që në qarkun e Dibrës për vitin 2012 nga *55, 293 fëmijë* gjithsej të grupmoshës 0-18 vjeç, *43, 388* prej tyre kanë jetuar në familje që janë mbështetur me NE.

Treguesi sipas rretheve jepet gjithashtu në tabelën 1. Në rrethin e Bulqizë nga *12, 553 fëmijë* 0-18 vjeç, kanë jetuar në familje në NE *11, 246 fëmijë*. Në rrethin e Dibrës nga *25,471 fëmijë* 0-18 vjeç, kanë jetuar në këtë kategori *19,394 fëmijë.*
Ndërsa në rrethin e Matit fëmijë 0-18 vjeç në këto familje janë vlerësuar në numër *12,748* nga *gjithsej 17, 269* të grupmoshës 0-18 vjeç.

Për të pasur mundësi të vlerësojmë masën e fëmijëve të mësipërm ndaj numrit të përgjithshëm të fëmijëve të kësaj grupmoshe, treguesin në numër e kemi përllogaritur në % sipas rretheve dhe në nivel qarku. Të dhënat e përftuara janë si me poshtë.

Burimi. Llogaritur nga Observatori Dibër



Grafik 1. *Përqindja e fëmijëve që jetojnë në familje në NE, Dibër 2012*

Nga grafiku 1 shihet që në nivel qarku rreth 78,5 % e fëmijëve të grupmoshës 0-18 vjeç në vitin 2012 kanë jetuar në familje që kanë qenë pjesë e skemës së NE.

Megjithatë treguesi ka ndryshime mes rretheve.
Përqindjen më të lartë e ka rrethi Bulqizë me 89,6 % të fëmijëve 0-18 vjeç që kanë jetuar në familje në NE, rrethi Dibër ka nivelin 76,1 % të fëmijëve ndërsa treguesi është me i ulët në Mat, në nivelin 73,8 %.
I shprehur në % treguesi na jep mundësinë të bëjmë vlerësimin e situatës nga njëra anë dhe njëkohësisht të shohim ndryshimet e tij mes rretheve të qarkut.

Nga grafiku 1. Duket qartë që fëmijët që kanë jetuar në kushte të vështira ekonomike kanë qenë në masë të konsiderueshme. Më problematike duket situata në rrethin e Bulqizës, në të cilin vlera e treguesit është mbi nivelin e qarkut.
E analizuar në nivel njësish vendore sipas rretheve,situata na paraqitet si vijon.

Burimi. Llogaritur nga Observatori Dibër

Harte 1. *Përqindja e fëmijëve 0-18vjeç, q*ë *jetojn*ë *n*ë *familje n*ë *NE n*ë *rrethin e Bulqizës,viti 2012*

Grafiku 1 tregon % e fëmijëve 0-18 vjeç (ndaj totalit të gruposhës 0-18 vjeç gjithsej), që kanë jetuar në familje të mbështetura në skemën e NE për vitin 2012 nga njësitë vendore ne rrethin e Bulqizës.
Nga grafiku duket që situata e familjeve me fëmijë është e ndryshme në njësitë vendore të rrethit. Në komunat Martanesh, Ostren dhe Shupenzë të gjithë fëmijët 0-18 vjeç jetojnë në familje që mbështeten me NE.
Kjo do të thotë në tre njësitë vendore të mësipërme të gjithë fëmijët jetojnë në familje të varfra. Ky fakt tregon qartë që fëmijët jetojnë në kushte të varfërisë ekonomike dhe pamundësisë së përmbushjes së nevojave të tyre bazë.

Në këto kushte të drejtat e fëmijëve nuk mund të jenë prioritet,pasi prioritet i këtyre familjeve është sigurimi i jetesës dhe në disa prej tyre dhe mbijetesa.
Niveli i dyte i % që fëmijëve 0-18 vjeç që jetojnë në familje në NE është në komunat Gjoricë me *93.3 % e fëmijëve* të kësaj grupmoshe që jetojnë në familje në NE. Në komunën Fushë Bulqizë ky tregues është në nivelin *83.6 %.*

Njësitë vendore me % më të ulët të familjeve me fëmijë 0-18 vjeç që jetojnë në familje në NE janë komuna Zerqan me 80.6 % dhe bashkia Bulqizë me 64.6 % të fëmijëve 0-18 vjeç që jetojnë në familje në NE.

Nga vlerësimi i hartës 1 dhe grafikut 1 vihet re që 4 nga 7 njësitë vendore të rrethit e kanë vlerën e treguesit mbi mesataren e rrethit Bulqizë. Këto njësi vendore janë komunat Ostren, Martanesh, Shupenzë dhe Gjoricë.

Nuk ka të dhëna për komunën Klenjë, pasi në DPGJC Tiranë të dhënat e kësaj komune i janë bashkuar komunës Ostren për shkak të rënies së numrit të banorëve vitet e fundit.

Nga paraqitja në hartë e bërë për njësitë vendore të rrethit Dibër lidhur me % e fëmijëve 0-18 vjeç që jetojnë në familje të NE, kemi paraqitjen si në hartën 2.

Burimi. Llogaritur nga Observatori Diber

Harte 2. *Përqindja e fëmijëve 0-18vjeç, që jetojnë në familje në NE në rrethin Dibër,viti 2012*

Nga harta 2 duket që njësitë vendore të rrethit Dibër janë në 2 grupime. Në grupin e parë bëjnë pjesë komunat Arras, Zall Dardhë, Sllovë, Kala e Dodës, Lurë, Selishtë dhe Luzni në të cilat vlera e treguesit është 100 %, që do të thotë se të gjithë fëmijët jetojnë në familje që mbështeten me NE. Vlera e treguesit në komunat e mësipërme është 100 %.
Megjithatë janë një numër tjetër komunash në të cilat vlera e treguesit është pothuaj 100 %, duke bërë që edhe në këto komuna pothuaj të gjithë fëmijët jetojnë në familje të varfra. Këto komuna janë Muhurr me 99.7 %, Melan 92.7 %.

Komunat ku vlera e treguesit është disi më e ulët janë Tomin me 79.4 % , Fushë Çidhën me 72.7 %, Maqellarë me 72.2 % , Kastriot me 53.7 % . Vlera më e kënaqshme e treguesit të mësipërm në rrethin e Dibrës vihet re në bashkinë Peshkopi me vetëm 19.7 % e fëmijëve 0-18 vjeç që jetojnë në familje në NE.

Njësitë vendore që kanë % të fëmijëve 0-18 vjeç që jetojnë në familje në NE në masë më të madhe se mesatarja e rrethit Dibër janë 10 nga 14.
Nën 76. 1 % që është mesatarja e Dibrës janë komunat Fushë Çidhën, Maqellarë dhe Kastriot si dhe bashkia Peshkopi.

Edhe për komunën Zall Reç nuk ka të dhëna, pasi të dhënat mbi popullsinë janë bashkëngjitur në komunën Zall Dardhë dhe për këtë njësi nuk mund të bëhen llogaritje.

Në vijim është bërë paraqitja në hartë e të dhënave për këtë tregues për njësitë vendore të rrethit Mat.
Mati ka gjithsej 12 njësi vendore nga të cilat 2 bashki, Burreli dhe Klosi si dhe 10 komuna.
Megjithatë në vlerësim të treguesit janë 11 njësi vendore, pasi Macukulli i është bashkëngjitur komunës Derjan për shkak të numrit të vogël të banorëve.

Treguesi do vlerësohet duke iu referuar nivelit të treguesit në vlerësim për rrethin e Matit.
Nga tabela 1 shihet që Mati si rreth ka 73. 8 5 të fëmijëve 0-18 vjeç që kanë jetuar në familje në NE për vitin 2012.

Të paraqitura në formë hartë të dhënat për të gjitha komunat dhe bashkitë e rrethit Mat janë si më poshtë.

Burimi. Llogaritur nga Observatori Dibër



Harte 3. *Përqindja e fëmijëve 0-18vjeç, që jetojnë në familje në NE në rrethin e Mat,viti 2012*

Nga harta 3 shihet që njësitë vendore në rrethin Mat janë në 4 nivele. Më keq është situata në komunat Xibër dhe Derjan në të cilat të gjithë fëmijët 0-18 vjeç janë në skemën e NE. Megjithatë edhe komuna Baz është praktikisht pothuaj 100 % (saktësisht 99.8 %).

Më pas vijnë komunar Gurrë me 83.1 % dhe Lis me 76.8 % .
Më pas vijnë bashkia Klos me 72.5 % . komunat Rukaj me 68.2 % , Suç me 66.7 % .

Komunat me situatë më të ulët të varfërisë të shprehur nëpërmjet këtij treguesi janë Ulëz me 53.2 % , bashkia Burrel me 50.4 % dhe komuna Komsi me 47.9 % .
Njësitë vendore të cilat e kanë % e fëmijëve që kanë jetuar në familje në NE mbi mesataren e rrethit janë 5 nga 11 gjithsej dhe konkretisht komunat Xibër, Derjan, Baz, Gurrë dhe Lis.
Kjo ishte një analizë e detajuar e % së fëmijëve që jetojnë në familje të varfra në të gjitha njësitë vendore në qarkun Dibër.

Nga diskutimet me ekspertët rajonalë rezulton se pagesa sipas skemës së NE për çdo fëmijë është *700 lekë/muaj*[8]. E vlerësuar si vlerë e krahasuar me nevojat optimale të një fëmije në muaj për burime financiare në përmbushje të nevojave të tij për një jetë normale pagesa sipas skemës së NE është shumë më e vogël. Ky konstatim konfirmohet edhe nga diskutimet me prindër të këtyre fëmijëve, po ashtu edhe nga vizitat në këto familje.
Janë përgjithësisht familje të varfra, që jetojnë në vështirësi ekonomike. Megjithëse është e vështirë të vlerësohet masa e të ardhurave në familje nga burime të ndryshme, ekspertët e mësipërm gjykojnë se familjet me fëmijë që jetojnë në NE praktikisht konsiderohen si familje të varfra. Megjithatë shkalla e varfërisë faktikisht mendohet të jetë më e lartë. Kjo sepse një pjesë e familjeve të varfra (ndonjëherë edhe shumë të varfra) nuk janë pjesë e kësaj skeme. Kriteri përjashtues për ta është fakti se familja disponon në përdorim sipërfaqe toke. Kjo nënkupton që familja siguron të ardhura në natyrë, duke mos u konsideruar kështu në nevojë.

Nga të dhënat e prezantuara më sipër u pa dukshëm se në pjesën dërrmuese të njësive vendore në qark pothuaj të gjithë fëmijët jetojnë në familje që mbështeten me NE. Është kjo arsyeja pse

[8] Informacion I marrë gjatë takimeve me ekspertët dhe punonjësit e DRSHS Dibër, nëntor 2013.

analiza është ndalur këtu dhe nuk është bërë për grupmoshat e ndryshme brenda kategorisë "fëmijë", pasi niveli i vlerës 100 % është automatikisht edhe për grupmoshat më vete.
Duke mbetur përsëri tek NE, si një tregues direkt që mat nevojat për burime financiare, treguesi tjetër plotësues që mat nivelin e varfërisë brenda familjeve të kësaj kategorie është ***numri i familjeve me fëmijë 0-18 vjeç, të cilat janë në skemën e ndihmës ekonomike***
Për vitin 2012 të dhënat lidhur me këtë tregues do jepen në vazhdim të raportit/analizës.

Burimi. DRSHS Dibër

Njësia vendore	Numri i familjeve
Bulqizë	2507
Dibër	4700
Mat	3095
Diber (qark)	**10302**

Tabele 2. *Numri i familjeve me fëmijë, të cilat janë në NE, Dibër 2012*

Nga tabela 1 shihet që në qarkun e Dibrës për vitin 2012 janë gjithsej *10, 302 familje me fëmijë* të grupmoshës 0-18 vjec, që janë mbështetur me NE.

Treguesi sipas rretheve jepet gjithashtu në tabelen 2. Në rrethin e Bulqizës 2*, 507 familje me fëmijë* 0-18 vjec janë mbështetur me NE, në rrethin e Dibrës janë *4,700 familje në NE me fëmijë* 0-18 vjec,

Ndërsa në Mat kanë jetuar në këtë kategori *3,095 familje me fëmijë* kanë qenë në skemën e NE.
I vlerësuar ky tregues sipas peshës qe ai zë ndaj numrit total të familjeve për çdo njësi vendore, paraqitet në hartën 4.

Burimi. Llogaritur nga Observatori Dibër



Harte 4. *Përqindja familjeve me fëmijë 0-18vjeç, që mbështeten me NE në qarkun e Dibrës,viti 2012*

Nga harta e mësipërme vihet re që familjet që përfitojnë NE dhe që kanë fëmijë janë në masë të ndryshme. Peshën më të madhe ndaj totalit të familjeve, kjo kategori e zë në Sllovë me 52.5 % ,

Selishtë me 52.2 % , Xibër me 43.8 % , Luznia me 42.2 % , Zall Dardha me 40.2 % , Lurë me 37,2 % , Klenjë me 35,1 %.

Njohja e këtij treguesi vlen jo vetëm për vlerësimin e varfërisë në familjet me fëmijë, por edhe masën e saj përkundrejt familjeve në total të çdo njësie vendore.

Deri tani folëm si për varfërinë e shprehur nëpërmjet treguesve të NE. Megjithatë varfëria thellohet më tepër në disa nënndarje brenda grupit të madh të familjeve në skemën e NE, ***familjet në NE me fëmijë 0-18 vjeç dhe që drejtohen nga kryefamiljar gra.***
Kontributi i munguar i drejtuesit të familjes, si dhe vështirësitë që gruaja has në përmbushjen e rolit të saj të dyfishtë për shkak të mentalitetit, bën që jetesa e fëmijëve në këto familje të jetë edhe më e vështirë se familjet e tjera që përfitojnë NE.
Numri i familjeve në NE që drejtohen nga gratë dhe që kanë fëmijë 0-18 vjeç sipas njësive vendore jepet në tabelën 5.

Burimi. DRSHS Dibër

Harte 5*. Numri i familjeve në NE, qe kane fëmijë 0-18 vjeç dhe që drejtohen nga kryefamiljare gra.*

Në tabelën 5 jepen numri i familjeve me fëmijë, që janë në skemën e NE dhe që drejtohen nga kryefamiljare gra, në të gjitha njësitë vendore ne qarkun e Dibrës. Nga harta vihet re që kjo kategori është me shumë e përqendruar në bashkinë Burrel me 110 familje, bashkia Bulqizë me 93 familje, bashkia Peshkopi me 80 familje, komuna Kala e Dodës me 77 familje.
Megjithatë janë edhe 9 komuna në qark në të cilat numri i familjeve me fëmijë që janë në skemën e NE dhe ku mungon kryefamiljari, siç tregohet në hartë.
Krahas varfërisë në përmbushjen e nevojave gjatë procesit të rritjes, varfëria në fëmijët e këtyre familjeve ka mjaft efekte në të ardhmen e tyre.
Duke mos pasur mundësi të kenë financimet e nevojshme nga ana e familjes në procesin e edukimit (ndjekja e kurseve të ndryshme, aksesi në internet dhe mundësia e shtimit të dijeve në përputhje me shkallën e rritjes, etj), bën që fëmijët e këtyre familjeve të rriten me shume me pak mundësi se sa fëmijët e tjerë, edhe në familjet që janë në NE.
Shpesh këta fëmijë detyrohen të punojnë shumë të vegjël sidomos nëse janë djem, ose nuk ndjekin arsimin e mesëm, aq me pak atë të lartë nëse janë vajza.

Në një vlerësim me nga afër te këtyre fëmijëve, vihet re edhe njëfarë përjashtimi në aspektin social që ato përjetojnë. Duke mos qenë të barabartë në aspektin e përmbushjes së nevojave që kërkojnë burime financiare, këta fëmijë janë disi të tërhequr, nuk e kanë mundësinë të jenë pjesë e grupeve të fëmijëve që jetojnë në kushte më të mira ekonomike, në përgjithësi kanë një shkallë

më të ulët të informacioneve për çështje te ndryshme aktuale, për rrjedhoje vihet re njëfarë përjashtimi i tyre nga grupet aktive të fëmijëve në klasa e shkolla.

Deri tani raporti prezantoi numrin dhe % e fëmijëve dhe familjeve që mbështeten me NE në nivel qarku dhe sipas njësive vendore.
Megjithatë një anë tjetër e politikave të mbështetjes së familjeve me probleme sociale mund të vlerësohet edhe duke pare ***fondin e akorduar nga qeveria për familjet në ndihmë ekonomike dhe fëmijët që jetojnë në këta familje.***
Nga informacionet e marra në nivel rajonal fondi i akorduar nga qeveria shqiptare për skemën e NE për qarkun e Dibrës në vitin 2012 ka qenë *619, 584, 000 leke*[9] i shpërndarë për 14, 413 familje në nivel qarku.
Duke qenë se ky fond është përdorur jo vetëm për fëmijët, por dhe të rritur, llogaritja e mbështetjes mesatare për çdo fëmijë bëhet sipas metodave të përafërta, por të unifikuara të cilat na japin afërsisht sa është masa e përfitimit nga çdo fëmijë në një vit të dhënë.

Nga të dhënat e marra fondi mesatar i përfituar nga çdo fëmijë llogaritet në tabelën e mëposhtme.

Burimi. DRSHS Diber 2012

Vitet	Ndihma ekonomike (në 000 lekë)	Nr i familjeve përfituese	Numri i personave në këto familje	Numri i fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijët (në 000 lekë)	Buxheti për një fëmijë (në 000 lekë)
a	**b**	**c**	**d=c*4.2**	**e=c*2.2**	**f=(b/d)*e**	**g=b/f**
2009	601,332	13,735	57,687	30,217	314983	10.42
2010	612,700	13,664	57,389	30,061	320938	10.68
2011	623,850	14,447	60,677	31,783	326779	10.28
2012	619,584	14,413	60,535	31,709	324544	10.24

Tabele 3. *Fondi i NE për qarkun Dibër për vitet 2009-2012*

Nga tabela 3 vihet re që është rritur fondi i NE për vitet në studim (2009-2012). Megjithatë shihet që edhe numri i familjeve pjesë e skemës së NE është rritur. Rritja e numrit të familjeve që janë pjesë e skemës së NE është një tjetër tregues i rritjes së masës së varfërisë në familjet e qarkut Dibër.
Por nëse shohim buxhetin mesatar për fëmijë në vitin 2012 ai përllogaritet në masën 10.240 lekë në vit[10].
E krahasuar me vlerën e përcaktuar në kuadër të dokumenteve strategjike kombëtare, fëmijët në Dibër jetojnë me shumë pak të ardhura (përfitojnë nga mbështetja e qeverise një pagesë e cila nuk mbulon nevojat e tyre për jo më shumë se 2 muaj).

Nëse shohim tendencën e mbështetjes që mesatarisht çdo fëmijë ka marrë në vit nëpërmjet skemës se NE, ajo na paraqitet si në grafikun e mëposhtëm.

[9] Sipas të dhënave të marra nga DRSHS Dibër për vitin 2012.
[10] Llogaritje të Observatorit Dibër bazuar në të dhënat e marra nga DRSHS Dibër për vitin 2012.

Burimi. Llogaritje te bëra nga Observatori Dibër



Grafik 2. *Buxheti mesatar vjetor (në 000 lekë) dhënë për çdo fëmijë në NE për qarkun Dibër për vitet 2009-2012*

Nga tabela 4 shihet që gjatë 2 viteve të fundit mbështetja mesatare për fëmijë ka pësuar një rënie, duke ndikuar treguar qartë që skema e Ne nuk ka mundur të ndikojë pozitivisht në reduktimin e varfërisë në Dibër.
Nëse treguesin e mësipërm e marrim bashkë me faktin që shumica e familjeve në Dibër janë pjesë e skemës së NE për një kohe shumë të gjatë, na bën të kuptojmë që varfëria është bashkudhëtare e rritjes së një numri të konsiderueshëm fëmijësh në qark.

Përveç fondit të NE, nga ana e qeverisë në Dibër vjen edhe fondi për mbështetjen e personave me aftësi te kufizuara. Megjithatë në nivel rajonal ai nuk rezulton i ndarë në fond për fëmijët e këtij grupi dhe fondin për të rritur. Gjithsesi për periudhën 2009 – 2012 ai ka qenë si më poshtë:

Burimi. DRSHS Dibër

Vitet	2009	2010	2011	2012
Fondi i akorduar	617,058	753,700	673,455	650,604

Tabele 4. *Fondi total (ne 000 leke) dhënë për personat me AK për qarkun Dibër për vitet 2009-2012*

Nga tabela 5 shihet dukshëm që fondi i ofruar nga shteti për këtë kategori është i konsiderueshëm. Pavarësisht problemeve të banorëve të rajonit ne aspektin ekonomik, këto 2 pagesa në total janë të konsiderueshme (NE dhe AK) dhe padyshim kane ndikim në jetesën e familjeve dhe fëmijëve. Por nuk janë të mjaftueshme. Ato duhet të jenë njëkohësisht tregues direkt të orientimit të planeve të veprimit për përmirësimin e nivelit ekonomik të qarkut Dibër.

4. Buxhetet vendore dhënë nga qeverisja qendrore

Siç dihet, njësitë vendore përgjithësisht kanë 3 burime të sigurimit të mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve të tyre, fonde nga buxheti i shtetit, të ardhura nga taksat lokale si dhe fonde të siguruara nga donatorët e ndryshëm.
Duke qenë se buxheti i shtetit është burimi më i madh i të ardhurave, masa e tij është tregues i rëndësishëm i mundësive të përmbushjes së prioriteteve në një vit të dhënë.
Ky tregues është matur edhe në vitin 2012, duke llogaritur buxhetin mesatar për frymë sipas njësive vendore, i akorduar nga buxheti i shtetit. Për të gjitha njësitë vendore, sipas rretheve për qarkun Dibër të dhënat jepen në vazhdim.

Burimi. Zyra e programimit, Këshilli i qarkut Dibër



***Harte 6**. Buxheti mesatar për frymë akorduar nga buxheti i shtetit, Bulqizë 2012.*

Në hartën 1 jepet fondi i akorduar për frymë për të gjitha njësitë vendore të rrethit Bulqizë. Nga harta vihet re njëfarë shpërndarje e diferencuar e fondeve nga buxheti i shtetit brenda njësive vendore në rrethin e Bulqizë.
Nga diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të strukturave në qark rezulton se ky ndryshim është në përputhje me politikat kombëtare dhe favorizimin e komunave me kushte më të vështira. Gjithashtu njësitë vendore që e zhvillojnë aktivitetin e tyre në territore më të favorshme dhe me më shumë mundësi se njësitë e tjera ne secili rreth, kanë koeficientë më të lartë të konvertimit të nevojave, krahasuar me mundësitë e mbështetjes nga ana e buxhetit të shtetit për komunat dhe bashkime në përgjithësi.
Nga harta 6 shihet që mbështetja mesatare për banor ka qenë më e madhe në komunat Martanesh dhe Klenjë, me pas vijnë komunat Zerqan dhe Ostren. Kanë pasur nivel më të ulët të treguesit bashkia Bulqizë dhe komuna Fushë Bulqizë. Ndërsa komunat Shupenzë dhe Gjoricë kanë marrë mbështetje më të ulët financiare për frymë nga buxheti i shtetit në vitin 2012.
Në terma statistikorë njësitë vendore kanë përfituar mbështetje për frymë nga ky burim financimi në limitet 2829 lekë/vit për banor në kufijtë maksimal prej 7300 lekë/banor në vit.
Vlera prej 7300 lekë është për komunën Martanesh, ndërsa komuna Klenjë me nivel gjithashtu të lartë mbështetje ka nivel treguesi në vlerën 6251 lekë/vit për banor.
Në nivelin e dytë të mbështetjes janë komunat Zerqan me 4246 lekë/banor në vit dhe komuna Ostren me 4146 lekë/vit për banor.
Me pas vijnë komuna Fushë Bulqizë me 3722 lekë/banor në vit dhe bashkia Bulqizë me 3703 lekë/vit për banor.
Në komunën Shupenze mesatarja është 3313 lekë/banor në vit, ndërsa në komunën Gjoricë fondi për person është 2829 lekë/vit.
Kjo politike e diferencuar mbështetje vlerësohet si pozitive nga drejtuesit lokal, pasi në njëfarë mënyre zbut diferencat në mundësitë për shërbime mes njësive vendore në çdo rreth.
Gjithashtu ajo merr në konsideratë nevojat e ndryshme për shërbime bazë që kanë njësitë vendore, në përputhje me nivelin e infrastrukturës, nevojat për mirëmbajtje dhe mundësinë e banorëve për të marrë shërbimet bazë edhe në situata të vështira të motit apo për faktorë të tjerë

objektive, të cilët sidomos në rajonin e Dibrës janë të pranishëm dhe ndikojnë jetën e banorëve të rajonit.
I vlerësuar për njësitë vendore të rrethit Dibër, mbështetja për frymë nga buxheti i shtetit për vitin 2012 jepet në hartën 7.

Burimi. Zyra e programimit, Këshilli i qarkut Dibër



***Harte 7**. Buxheti mesatar për frymë akorduar nga buxheti i shtetit, Dibër 2012.*

Nga harta 7 shihet që edhe në rrethin e Dibrës ka 4 nivele të mbështetjes së komunave dhe bashkisë Peshkopi.
Gjithashtu edhe në Dibër prioritet kanë komunat më të largëta dhe konkretisht komuna Lurë me 9056 lekë/banor në vit, komuna Zall Reç me 6224 lekë/banor, komuna 6113 lekë/banor.
Me më pak mbështetje se të parat janë bashkia Peshkopi me 5325 lekë/banor, komunat Kala e Dodës me 4182 lekë/banor, Sllovë me 4150 lekë/banor dhe Melan me 3574 lekë/banor.
Në nivelin e tretë të mbështetjes vijnë komunat Arras me 3492 lekë/banor, Arras me 3492 lekë/banor,Muhurr me 3475 lekë/banor dhe komuna Luzni me 3265 lekë/banor në vit për 2012.
Në kategorinë e komunave me mbështetje më të vogël në nivel rrethi janë komunat Fushë Çidhën me 2795 lekë/banor, Tomin me 2736 lekë/banor, Kastriot me 2607 lekë/banor dhe komuna Maqellarë me 2417 lekë/banor.

E njëjta analizë e bërë për këtë tregues për njësitë vendore të rrethit Mat jepet në vazhdim.

Burimi. Zyra e programimit, Këshilli i qarkut Dibër



***Harte 8**. Buxheti mesatar për frymë akorduar nga buxheti i shtetit, Mat 2012.*

Nga një vështrim i përgjithshëm i hartës 8 shihet që edhe për rrethin Mat kemi 4 nivele mbështetje.
Kanë përfituar mbështetje më të madhe komunat Derjan me 6149 lekë/banor, Macukull me 5207 lekë/banor si dhe bashkia Burrel me 4591 lekë/banor.
Në nivelin e dytë të mbështetjes vijnë bashkia Klos me 4430 lekë/banor, komunat Ulëz me 4063 lekë/banor dhe Bazë me 3998 lekë/banor.
Në nivelin e tretë te mbështetjes vijne komunat Lis me 3468 leke/banor dhe Suc me 3216 leke/banor.
Komuna me më pak mbështetje në nivel rrethi janë Rukaj me 2813 lekë/banor, Komsi me 2641 lekë/banor dhe Gurrë me 2513 lekë/banor.

Megjithëse treguesi i mësipërm nuk ndikon direkt në varfërinë ekonomike në nivel familje, ai është tregues i eksesit të banoreve të çdo njësie vendore ndaj mundësive dhe burimeve në komunitetin ku ato jetojnë.
Gjithashtu në shohim edhe një vëmendje të diferencuar nga qeverisja qendrore në nivel lokal duke marrë në konsiderate mundësitë dhe burimet specifike.
Megjithatë fakti që ka pak burime lokale financiare të cilat janë aktive në procesin e zhvillimit, bën që rajoni të jetë në nivele të ulëta ekonomike dhe varfëria të jetë një problem prezent afatgjatë në gjithë rajonin e Dibrës.

- ***Buxheti për fëmijët për Këshillin e qarkut Dibër***

Buxheti i shtetit për Këshillin e qarkut Dibër për vitet 2011 dhe 2012 është si me poshtë:

Burimi. Këshilli i qarkut Dibër

Vitet	2011	2012
Fondi i akorduar	124,266,959	127,417,094

Tabele 5. *Fondi total dhënë për Këshillin e qarkut Dibër për vitet 2011-2012*

Nga tabela 5 shihet që në vitin 2012 fondi i akorduar nga qeveria shqiptare për Këshillin e qarkut Dibër është rritur krahasuar me vitin 2011.
Kjo rritje vlen për tu theksuar, duke pasur parasysh që ritmet e rritjes së popullsisë në 2012 kanë qenë të vogla krahasuar me vitin 2011. Megjithatë duke pasur parasysh nevojat e mëdha që ka qarku për burime financiare, fondet qeveritare nuk mund të jenë zgjidhje afatgjate për përmirësimin e situatës ekonomike në Dibër.

5. Varferia jomateriale

Në fakt perceptimi i parë që na vjen ndër mend kur flasim për varfërinë janë treguesit ekonomik që lidhen me të mirat materiale (në natyre ose në vlerë) që familja, komuniteti apo njësia vendore ka në përdorim në përmbushje të nevojave të anëtareve të saj.
Megjithatë ajo reflektohet dukshëm edhe në nivelin e përmbushjes së nevojave sidomos të fëmijëve në aspektin social
E parë në këtë këndvështrim mund të themi se në Dibër situata është vërtetë problematike. Për shkak të buxheteve tejet të kufizuara në gjithë periudhën e pas tranzicionit, infrastruktura në shkolla është përgjithësisht problem, sidomos në shkollat e ciklit të ulët në të cilat investimet për mirëmbajtje janë shumë të pakëta. Baza materiale në shkolla është gjithashtu shumë e pakët dhe mundësia e konkretizimit të mësimit dhe nxitjen e nxënësve për të fituar shprehi praktike nuk është e mundur. Ka shumë pak shkolla që kanë ambiente sportive, nuk ka kënde lojërash apo ambiente të tjera argëtuese për fëmijët. Njësitë vendore nuk kane buxhete te ndare për te mbështetur iniciativat e fëmijëve për organizimin e aktiviteteve të ndryshme.

Rast
D. është 12 vjeç. Ai jeton në qytetin e Bulqizë. Prej vitesh nuk e ka të atin. E ëma mundohet të punojë, por në qytetin ku ato jetojnë nuk ka mundësi të gjejë pune. Jetojnë në një shtëpi jo shumë të mbajtur. Mbledhja e gurëve të kromit është e vetmja mundësi për familjen e tij. Ai shkon çdo pasdite me të ëmën në stoqet afër qytetit të tyre dhe mbledhin gurë për ti shitur.
Megjithëse të ardhurat që sigurojnë nga kjo punë janë shumë të pakta, ai është i detyruar të ndihmojë të ëmën pasi ju duhet të ushqehen.
Në këto kushte D. nuk shkon shumë mirë me mësime, por kjo është mundësia e tij për të jetuar. Ai padyshim do donte një jetë më të mirë për të ëmën dhe gjithë familjen e tij, por nuk e di si mund të arrihet kjo gjë.

IV - Prezantimi i gjetjeve kryesore

- Varfëria është prezent në Dibër, si një problem që ka bashkëjetuar në këtë rajon prej vitesh.

- Niveli i përdorimit të burimeve lokale/rajonale ndër vite në funksion të zhvillimit rajonal dhe reduktimit të varfërisë nuk shihet të këtë ndikuar dukshëm nder vite.

- Është e vështire ta masësh problemin nëpërmjet treguesve direkt, pasi të dhëna të tilla është e vështirë të gjenden.

- Kriteret e dhënies së ndihmës ekonomike në disa raste përjashtojnë familjet që janë në nevojë ekstreme.

- Familjet pjesë e skemës së NE në disa raste kanë burime të padeklaruara dhe përfitojnë padrejtësisht prej saj.

- Varfëria absolute është një problem që ndeshet në qarkun e Dibrës. Përjashtimi social sidomos për fëmijët e këtyre familjeve bën që atyre t'ju privohen pothuaj të gjitha të drejtat. Megjithatë nuk ka informacione numerike bazë mbi të cilët të përcaktohet numri i këtyre familjeve dhe fëmijëve.

- Punësimi i fëmijëve ndeshet në rrethin e Dibrës dhe në disa raste ato janë të ekspozuar ndaj një shkalle të lartë rreziku. Niveli i ulët ekonomik në zonë dhe të ardhurat e pakta që sigurohen nga punësimi, bëjnë që fëmijët të llogariten si forca potenciale pune brenda familjes, megjithëse për shkak të moshës ato nuk janë të tillë.

- Fëmijët që jetojnë në familje që mbështeten me ndihmë ekonomike dhe që drejtohen nga kryefamiljare gra jetojnë në një shkallë të konsiderueshme përjashtimi social, për shkak të mundësive të kufizuara financiare brenda familjeve të tyre.

- Është e vështirë të matet varfëria jomateriale për shkak të nivelit të ulet ekonomik në rajon dhe vështirësive në përmbushjen e nevojave jetike bazë për familjet në përgjithësi.

V - Rekomandime

- Rivlerësimi i skemës së mbështetjes së familjeve në nevojë me NE. Përjashtimi i familjeve për faktin se disponojnë toke duhet riparë. Vlerësimi i kapacitetet të saj prodhues është domosdoshmëri, për ta bërë skemën e NE me funksionale dhe në mbështetje të familjeve me të varfra.

- Nxitja e politikave të punësimit në nivel vendor është i domosdoshëm për rritjen e mundësive për respektimin e të drejtave të fëmijëve nga familja dhe komuniteti. Gjithashtu një gjë e tillë redukton përjashtimin social dhe pabarazinë mes fëmijëve.

- Duhen ndërhyrje urgjente nga njësitë vendore dhe strukturat e tjera lokale rajonale për të mos lejuar fëmijët të punojnë në proces pune me rrezik shumë të lartë, punë në të cilat sipas të dhënave nga vitet e kaluara ka pasur raste të humbjes së jetës së personave edhe të rritur.

- Identifikim i saktë i problemeve të fëmijëve në NE dhe që kanë kujdes prindërore vetëm nga nënat dhe programe përfshirje për këtë kategori fëmijësh. Kjo pasi për shkak të mentalitetit nënat nuk mund të luajnë njëkohësisht edhe rolin e babait, pavarësisht dëshirave të tyre.

- Vlerësimi i ndikimit të varfërisë në aspektin social. Varfëria jomateriale është faktori që po ndikon negativisht në përhapjen e problemeve të ndryshme tek fëmijët (droga, duhani, alkooli, dhuna).

Bibliografia

1. Raportet e Observatorit Diber për vitin 2009 - 2011
2. Matja e mirëqenies së femijëve në Shqipëri duke perdoruar vrojtimet MICS dhe ADHS, V Kolpeja,
3. Kushtet e jetesës dhe pabarazia në Shqipëri, INSTAT 2002
4. Vendimi Nr 182, dare 13.3.2012, Për miratimine planit të veprimit për fëmijë, 2012-2015
5. VKM 266, date 12.4.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;
6. Varfëria e fëmijëve në Shqipëri për vitin 2012, Observatori 2013.

7. Informacionet e marra gjatë takimeve me eskpertet dhe punonjesit e DRSHS Dibër, nëntor 2013.
8. Statistika të marra nga DRSHS Dibër për vitin 2012.
9. Llogaritje të Observatorit Dibër bazuar në të dhënat e marra nga DRSHS Dibër për vitin 2012.

Aneks 1.

Çështjet orientuese ne grumbullimin e informacioneve cilësore kanë qenë si më poshtë:

1. Si e vlerësoni situatën ekonomike të familjeve të njësisë suaj?
2. Në ç'masë familja mundet të plotësoja nevojat e fëmijëve në përgjithësi?
3. Cilët janë faktorët që ndikojnë në varfërinë fëmijëve,
4. Sa është buxheti që shkon për këto familje,
5. Sa dhe si ndikon varfëria ne shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve,
6. Sa dhe si ndikon varfëria në frekuentimin dhe mbarëvajtjen e fëmijëve në shkollë,
7. Politikat për reduktimin e varfërisë tek fëmijët;
8. Hendeku i varfërisë, grupet me më pak mundësi